



**TELEKOM ALBANIA SH.A.**

Rr. "Vangjel Noti", Laprakë, Tiranë

**FLETË GARANCIE<sup>1</sup>**

EMRI I KLIENTIT	_____	DATA E BLERJES	_____
ADRESA	_____		
NUMËR TELEFONI	_____		
TIPI, MODELI I PRODUKTIT	_____	IMEI/ESN/SN	_____

**NËNSHKRIMI DHE VULA E PËRFAQËSUESIT TË SHITJES**

\_\_\_\_\_

**I. OBJEKTI I GARANCISË**

Telekom Albania i jep këtë garanci pa limit kohor personit i cili ka blerë produkt/in (et) e ofruara nga Telekom Albania përmes kanaleve të autorizuar të saj. Telekom Albania garanton se gjatë gjithë periudhës së garancisë dhe nëse dërgohet një ankesë e vlefshme, Telekom Albania, apo një kompani e autorizuar për shërbime riparimi/mirëmbajtje nga Telekom Albania sipas mundësisë<sup>2</sup> së vet dhe brenda hapësirës së lejuar ligjore, do të :

1. riparojë defektin në hardware pa asnjë pagesë, duke përdorur pjesë të reja ose të rinovuara të barazvlefshme me pjesët e reja përsa i takon performancës dhe sigurisë,
- ose
2. ndërrojë produktin me një produkt të ri ose të rinovuar që është i barazvlefshëm me produktin e vjetër në performancë, siguri dhe funksionalitet<sup>3</sup>.

Kjo Garanci është e vlefshme dhe e zbatueshme vetëm për të gjitha produktet që mbajnë logon Telekom Albania, produktet e blera në rrjetin e dyqaneve Telekom (duke përfshirë edhe dyqanet partnere dhe dyqanin elektronik) si dhe për produktet të cilat përfitohen me çmim të reduktuar nga aktivizimi i planeve tarifore individuale me kontratë 1 dhe 2 vjeçare. Kjo Garanci është e vlefshme dhe e zbatueshme vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

**II. AFATI I GARANCISË**

Afati i Garancisë fillon në momentin kur Produkti është blerë fillimisht nga përdoruesi i parë fundor. Produkti mund të përbëhet

<sup>1</sup> Garancia është e vlefshme vetëm nëse përmban të gjitha të dhënat e plotësuara saktë, nënshkrimin e palëve si dhe dhe vulën e kompanisë.

<sup>2</sup> Vlerësimi i defektit dhe nevojës për riparim bëhet nga Telekom Albania.

<sup>3</sup> Në rast zëvendësimi, bazuar mbi gjendjen e produktit, klientit mund t'i zëvendësohet paisja me një paisje me vlerë të njëjtë ose të përafërt. Diferenca e çmimit në këtë rast duhet të mbulohet nga klienti.



**TELEKOM ALBANIA SH.A.**

Rr. "Vangjel Noti", Laprakë, Tiranë

nga disa pjesë të ndryshme, të cilat mund të mblulohen nga afate të ndryshme garancie (këtu e në vijim referuar si "Afati i Garancisë"). Afatet e ndryshme të garancisë janë:

- a. Garanci pa Limit Kohor për Produktin përveç pjesëve që konsumohen dhe aksesoreve në pikat (b) dhe (c) më poshtë:
- b. Dymbëdhjetë muaj (12) për pjesët e mëposhtme që konsumohen dhe për aksesorët: bateri, karikues, mbajtës aparati, kufje, kablllo dhe kapakë; dhe
- c. Nëntëdhjetë ditë (90) për median me të cilin ofrohet çfarëdolloj software-i; p.sh. CD – rom, karta e memories.

Shërbimi i Garancisë do të ndërpritet në rastet e rishitjes së njëpasnjëshme, ose riparimit në kompani shërbimi të paautorizuara nga Telekom Albania.

**III. SI TË PËRFITONI SHËRBIMIN E GARANCISË**

Kërkesa për Garanci mund të paraqitet pranë çdo pike të shitjeve të Telekom Albania. Abonenti duhet të ketë me vete në momentin e paraqitjes:

- a) Fletën e Garancisë pa Limit Kohor,
- b) produktin,
- c) kuponin tatimor
- d) faturën origjinale dhe të pakorrigjuar të blerjes, ku janë shënuar në mënyrë të saktë emri dhe adresa e shitësit si dhe data dhe vendi ku është blerë produkti.

**IV. ÇFARË NUK PËRFSHIHET**

1. Kjo Garanci nuk mbulon manualët e përdoruesit apo cilindo software, rregullimet, përmbajtjen, të dhënat ose linket qofshin ato të përfshira/shkarkuara në Produkt, pa marrë parasysh nëse janë përfshirë gjatë instalimit, montimit, transportimit ose në çfarëdolloj momenti gjatë zinxhirit të dorëzimit ose të përfituar nga ju në çfarëdolloj mënyre tjetër. Në masën e lejuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi, Telekom Albania nuk garanton se çdo software i Produktit do t'i'u përgjigjet kërkesave tuaja, se do të funksionojë në kombinim me çfarëdolloj aplikimesh të hardware-ve apo software-ve të ofruara nga një palë e tretë, se funksionimi i software-it nuk do të ndërpritet ose do të jetë pa asnjë gabim dhe se defektet në software janë të riparueshme apo do të riparohen.

2. Kjo Garanci nuk mbulon:

- a) konsumimin normal të materialit (duke përfshirë pa kufizime konsumin e lenteve fotografike, baterive ose ekraneve),
- b) shpenzimet e transportit,
- c) defekte të shkaktuara nga përdorimi i keq (përfshirë pa kufizime defekte të shkaktuara nga objekte të mprehta, përkulja, shtypja ose rrëzimi, etj.),



**TELEKOM ALBANIA SH.A.**

Rr. "Vangjel Noti", Laprakë, Tiranë

ç) defekte ose dëme të shkaktuara nga përdorimi i gabuar i Produktit, përfshirë dhe përdorimin në kundërshtim me udhëzimet e dhëna nga Telekom Albania (p.sh., siç jepet në Manualin për Përdorimin e Produktit) dhe/ose veprime të tjera jashtë kontrollit të arsyeshëm të Telekom Albania.

3. Kjo Garanci nuk mbulon defekte apo defekte të supozuara të shkaktuara nga fakti se Produkti është përdorur me ose është lidhur me një produkt, aksesor, software dhe/ose shërbime të cilat nuk janë prodhuar, ofruar, apo autorizuar nga Telekom Albania, ose që janë përdorur për një qëllim të ndryshëm nga ai i përcaktuar.

Defektet mund të shkaktohen nga viruse si rrjedhojë e aksesit të paautorizuar nga ana e përdoruesit apo e personave të tretë në shërbime, llogaritë e tjera, sistemet apo rrjetet kompjuterike. Aksesit i paautorizuar mund të kryhet nëpërmjet hackersa-ve, zbulimit të fjalëkalimeve ose nëpërmjet mjeteve të tjera të ndryshme.

4. Kjo Garanci nuk mbulon defekte të shkaktuara nga fakti se bateria ka pësuar qark të shkurtër, ose nga fakti se izoluesit e baterisë janë thyer apo tregojnë që në to është ndërhyrë, ose nga fakti që bateria është përdorur në një pajisje tjetër të ndryshme nga ajo për të cilën është destinuar.

5. Kjo Garanci nuk është e vlefshme nëse Produkti është hapur, është modifikuar apo riparuar nga cilido person i paautorizuar për shërbim nga Telekom Albania, nëse është riparuar duke përdorur pjesë rezervë të paautorizuara ose nëse numri i serisë së Produktit, kodi i datës së prodhimit i aksesorëve të telefonit celular ose kodi IMEI janë hequr, fshirë, gërvishtur, ndërruar ose janë të jashtëligjshëm në çfarëdo mënyre, dhe do të përcaktohen sipas gjykimit të Telekom Albania. IMEI i paisjes së kthyer në pikat e shitjes Telekom, duhet të perputhen me IMEI-n e vendosur në këtë fletë garancie në momentin e blerjes së pajisjes.

6. Kjo Garanci pa Limit Kohor nuk është e vlefshme nëse Produkti është ekspozuar ndaj lagështirës, avullit ose kushteve ekstreme të nxehtësisë ose ambientit rrethues dhe ndryshimeve të shpejta të këtyre kushteve, korrozionit, oksidimit, derdhje të ushqimit ose lëngjeve ose nga ndikimi i produkteve kimike.

**V. NJOFIME TË TJERA TË RËNDËSISHME**

Ju lutemi, mbani mend që të bëni kopje rezervë ose të mbani shënim të gjitha përmbajtjet dhe të dhënat e rëndësishme të cilat ruhen në Produktin tuaj, pasi ato mund të humbasin gjatë riparimit ose zëvendësimit të Produktit. Në përputhje me dispozitat e parashtuara më poshtë në seksionin "Kuzime të përgjegjësisë së Telekom Albania", Telekom Albania brenda hapësirës së lejuar ligjore, në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet përgjegjëse, qoftë direkt ose indirekt, për çfarëdo dëmimesh ose dëmsh që vijnë si pasojë e humbjes, dëmtimit ose korruptimit të përmbajtjeve ose të të dhënave gjatë riparimit ose zëvendësimit të Produktit.

Telekom Albania mund të kërkojë që ju të zëvendësoni pjesët defektoze me pjesë të instalueshme nga përdoruesi, të reja ose të rinovuara, të cilat Telekom Albania i ofron në përmbushje të detyrimeve të veta në këtë garanci. Në rastet e ndërrimit të produktit ose një pjesë të tij, çdo pjesë e zëvendësuar bëhet pronë e Telekom Albania. Pjesët që do të ofrohen nga Telekom Albania, në përmbushje të detyrimeve të veta ndaj garancisë, duhet të përdoren në produktet për të cilat kërkohet shërbimi i zëvendësimit.

Në qoftë se konstatohet se Produkti i kthyer nuk mbulohet nga kushtet e Garancisë, atëherë Telekom Albania dhe kompanitë e shërbimit të autorizuara, gëzojnë të drejtën të vendosin një tarifë për shërbimin e kryer. Gjatë riparimit ose ndërrimit të Produktit, Telekom Albania mund të përdorë produkte ose pjesë të reja, ekuivalente të tyre ose të rinovuara.



**TELEKOM ALBANIA SH.A.**

Rr. "Vangjel Noti", Laprakë, Tiranë

**VI. KUFIZIMI I PËRGJEGJËSIVE TË TELEKOM ALBANIA**

Kjo Garanci përfaqëson masën rregullatore të vetme dhe ekskluzive që ju keni kundrejt Telekom Albania, si dhe përgjegjësinë e vetme dhe ekskluzive të Telekom Albania në lidhje me defektet e Produktit juaj. Megjithatë, kjo Garanci e Garanci pa Limit Kohor nuk do të përjashtojë dhe as të kufizojë 1) asnjë prej të drejtave tuaja të parashikuara me ligj sipas legjisllacionit Shqiptar; ose 2) asnjë prej të drejtave që ju linden kundrejt shitësit të Produktit.

Kjo Garanci zëvendëson të gjitha garancitë dhe përgjegjësitë e tjera të Telekom Albania, qoftë verbale, me shkrim (jo të detyrueshme), të parashikuara në ligj, qoftë në shkëlqe ose jo, përfshirëse, pa kufizime, dhe brenda hapësirave të lejuara nga ligjet në fuqi, çdo kusht indirekt, garancitë dhe kushte të tjera në lidhje me cilësinë e kënaqshme dhe përshtatshmërinë e Produktit me qëllimin. Telekom Albania, brenda hapësirës së lejuar nga legjisllacioni në fuqi, nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi për humbjen, dëmtimin ose korrupsionin e të dhënave, humbjen e ftimit, humbje në përdorimin e Produkteve ose të funksionimit të tyre, humbje të biznesit, humbjen e kontratave, humbje të të ardhurave ose humbje të kursimeve të planifikuara, rritje të shpenzimeve dhe kostove ose humbje apo dëme indirekte, humbje ose dëme të njëpasnjëshme ose humbje dhe dëme të veçanta.

Për aq sa e lejon ligji në fuqi, përgjegjësia e Telekom Albania kufizohet vetëm në vlerën e Produktit të ofruar. Kufizimet e mësipërme nuk zbatohen në raste vdekjeje ose dëmtimi fizik që vjen si rrjedhojë e neglizhencës së treguar nga Telekom Albania.

**VII. DETYRIME TË PARASHIKUARA ME STATUT**

Kjo Garanci duhet të interpretohet në përputhje me dispozitat e parashikuara me ligj të cilat nënkuptojnë garanci dhe kushte në këtë Garanci pa Limit Kohor të cilat nuk mund të përjashtohen, kufizohen apo ndryshohen ose nuk mund të përjashtohen, kufizohen apo ndryshohen përveçse në një shtrirje ligjore të kufizuar. Në rastin e zbatimit të këtyre dispozitave, brenda hapësirave që Telekom Albania mund ta bëjë këtë, përgjegjësia e saj nën këto dispozita do të jetë e kufizuar, sipas zgjedhjes së saj dhe në rastin e mallrave, deri në: zëvendësimin e mallit dhe furnizimin me mallra ekuivalente, riparimin e mallit, pagesën e shpenzimeve për zëvendësimin e mallit ose për blerjen e mallrave ekuivalente, ose pagesën e shpenzimeve për mallin e riparuar; kurse në rastin e shërbimeve: ofrimin sërish të shërbimeve ose pagesën e shpenzimeve për të ofruar sërish këto shërbime.

VINI RE! Produkti juaj është një aparat elektronik i sofistikuar. Telekom Albania ju inkurajon të studioni manualin e përdoruesit dhe instruksionet që ofrohen së bashku me Produktin dhe në lidhje me të. Gjithashtu, kini kujdes sepse produkti mund të përmbajë ekrane me precizion të lartë, lente për kamerat dhe pjesë të tjera, të cilat mund të gërvishten ose të dëmtohen, në qoftë se nuk përdoren me shumë kujdes.